



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 346/1 prot.

Tiranë, më 17.01.2025

Lënda: Dhënie mendimi lidhur me projektvendimin *“Për miratimin në parim të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për inteligjencën artificiale, të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës”*

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim *“Zyra e Komisionerit”*) ka administruar shkresën tuaj nr. 423/2 prot., datë 22.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 346 prot., datë 23.01.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin *“Për miratimin në parim të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për inteligjencën artificiale, të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës”* (në vijim *“projektvendimi”*), si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i materialit të vendosur në dispozicion, vërejmë se projektvendimi ka si qëllim, krijimin e një kuadri ligjor global të përbashkët, si dhe nxitjen e besueshmërisë së individëve gjatë përdorimit të sistemeve të inteligjencës artificiale.

Zyra e Komisionerit konstaton se, projektvendimi i referohet rregullave dhe parimeve bazë mbi mbrojtjen e të dhënave personale, llogaridhënies dhe transparencës, të parashikuara edhe në akte ndërkombëtare, që shërbejnë si garanci për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, projektvendimi është hartuar në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit, e për këto arsye shprehet dakord me miratimin e tij.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi